



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1816/3 prot.

Datë 29.08.2023

V E N D I M
Nr. 832/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.08.2023 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-75647-07-20-2023 me objekt “Blerje kancelari”, me fond limit 4,981,157.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 31-07-2023 nga autoriteti kontraktor Identitek Sh.A.

Ankimues: “Marketing & Distribution” SHPK
Autostrada Tirane - Durres, Km.10

“Infosoft Office” SHPK
Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Kashar

Autoriteti Kontraktor: Identitek Sh.A
Adresa: Bulevardi “Dëshmoret e Kombit”, Nd.1.Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik “i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimes dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimes kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21-07-2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-75647-07-20-2023 me objekt “Blerje kancelari”, me fond limit 4,981,157.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 31-07-2023 nga autoriteti kontraktor Identitek Sh.A.

II.2. Në datën 27.07.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3314, protokolluar me nr. 1847/2023 prot., datë 27.07.2023, e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020, “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës me nr. 1847/2 prot., datë 03.08.2023, KPP iu drejtua autoritetit kontraktor me detyrimin për dhënie informacioni KPP-së në lidhje me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Nga ana e autoritetit kontraktor nuk ka asnjë përgjigje në lidhje me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK.

II.6. Në datën 26.07.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3305 dhe me nr. 1816/2023 prot., datë 26.07.2023, e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 1816/2 prot., datë 03.08.2023, KPP iu drejtua autoritetit kontraktor me detyrimin për dhënie informacioni KPP-së në lidhje me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.9. Nga ana e autoritetit kontraktor nuk ka asnjë përgjigje në lidhje me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Marketing& Distribution” SHPK.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues,

Arsyeton:

III.1. Përpara shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorëve ekonomikë ankimes, KPP sqaron, se duke qenë se edhe pas kërkesave për informacion të KPP-së drejtuar autoritetit

kontraktor, nga ana e këtij të fundit nuk është dërguar asnjë informacion lidhur me procedurën e prokurimit objekt-ankimi, duke mos përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 114 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, për vënien në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, të shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës. KPP do të shqyrtojë kryesisht pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimes.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” ShPK ku kërkon: [...]“NË këtë procedurë prokurimi kërkohet të furnizohen mallra kancelarie të tillë si, axhenda ditore; dosje të ndryshme, zarfe, bateri të vogla, evidenciatorë, kapse të ndryshme aktesh, heqëse teli, stika, letër fotokopje, blloqe porosish, etiketa, etj., pra artikuj të thjeshtë kancelarie, të cilat i gjen lehtësisht në treg dhe që nisur nga natyra e tyre, sipas legjislacionit të fushës, prodhuesit, distributorët apo tregtarët nuk e kanë detyrim ligjor që në nxjerrjen e tyre në treg detyrimisht të shoqërojnë këto mallra me certifikata konformiteti ose cilesie ce ose ekuivalente, të leshuara nga nje organ i akredituar kombetare ose nderkombetar. Pra, autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë të paraqiten për efekt kualifikimi në procedurën e prokurimit, dokumente të tilla si certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent, për mallrat për të cilat ligji nuk ja kërkon prodhuesit/distributorit/ tregtarit si kusht për vendosjen e tyre në treg. Një kriter i tillë pengon dhe kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë pasi pamundëson pjesëmarrjen e tyre për shkak se certifikime të tilla nuk ekzistojnë ose janë të vështira për tu siguruar edhe nëse për artikuj të veçantë edhe ndoshta mund të lëshohen certifikime të tilla.[...].

Dhe lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” ShPK ku kërkon: 5.Operatori ekonomik ne lidhje me artikujt objekt prokurimi te percaktuar shtojcën 6 Formulari i sasisë dhe Grafiku i ekzekutimi, qe do te paraqese, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet te leshuara nga nje organ i akredituar. Nr. Emertimi i produktit/lëndës se parë Vendi i origjinës certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent akredituar 1 2 Etj., shënim 5.1: NË zbatim të ndryshimeve te reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prane AK certifikatat e cdo produkti jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit përfundimtarë 6. Me nenshkrimin e kontrates dhe dorezimin e artikujve operatori ekonomik krahas mallrave objekt prokurimi te paraqes prane AK per cdo produkt Certifikatat e origjinës. Per kete te paraqese detyrimisht nje deklarate se cdo produkt do te shoqerohet me certifikatat përkatëse të origjinë. Në lidhje me kriterin e mësipërm gjykojme që kjo kërkesë është shumë e ekzagjeruar, kufizuese dhe jo në proporcion me objektin e kontrates.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” për , “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 5 “Kapacitetin teknik”, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si vijon:

1. Operatori ekonomik ne lidhje me artikujt objekt prokurimi te percaktuar në shtojcën 6 Formulari i sasisë dhe Grafiku i ekzekutimit qe do te paraqese, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet te leshuara nga nje organ i akredituar.

Nr.	Emertimi i produktit/Lëndës se parë	Vendi i origjinës	Certifikatë cilësie	konformiteti ose CE/ekuivalent
1				
2				
Etj.,				

Shënim 5.1:

Në zbatim të ndryshimeve te reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prane AK certifikatat e cdo produkti jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit përfundimtar.

III.2.2. Në procesverbalin e datës 31.01.2023 “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM ” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues si më poshtë:

“Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standardit CE/ ose ekuivalent dhe direktivave lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi

Në shtojcën 5 “**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen specifikimet teknike të mallit, afatet, si më poshtë:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për

të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Nr.	Emërtimi	Njësia	Specifikime teknike
1	Axhendë ditore afërsisht 14.2x20.5 cm, min 300 faqe	copë	Axhenda ditore të ketë përmasat 14.2x20.5 cm (\pm 2 cm marzh gabimi), minimumi të ketë 300 faqe, të shkruhet viti, me logo ose jo sipas kërkesës së AK, me ngjyra të ndryshme sipas kërkesës së AK.
2	Dosje me mekanizëm, 7cm	copë	Dosje me mekanizëm A4 me kuti, 28x35x7 cm (marzh gabimi +/- 2 cm), me kuti, ngjyra të ndryshme sipas kërkesës së AK-së, me unazë metalike. Ngjyra e kutisë të jetë e njëjtë me ngjyrën e dosjes.
3	Dosje 4 unaza plastike, 3.5 cm	copë	Dosje A4 me 4 unaza. Kapaku të ketë trashësinë 500-700 mic. Përmasa 25x31x3.5 cm (marzh gabimi +/- 2 cm). Me ngjyra të ndryshme sipas kërkesave të AK-së.
4	Dosje kapak plastik me 2 kapëse	copë	Dosja të jetë material plastik, të ketë nga brenda 2 kapëse për fiksimin e materialeve, kapaku i parë të jetë transparent kapaku i dytë të jetë me ngjyra të ndryshme sipas kërkesës së AK-së. Përmasat e dosjes format A4.
5	Zarfa 11x23 cm	copë	Zarfi të ketë përmasat 11x23 cm (+/-1 cm marzh gabimi) me mbyllje me ngjitje, ngjyre e bardhë.
6	Zarfa 19x26 cm (A5)	copë	Zarfi të ketë përmasat 19x26 cm (+/-1 cm marzh gabimi) me mbyllje me ngjitje, ngjyrë e bardhë.
7	Zarfa 23x33 cm (A4)	copë	Të jenë letre, përmasat 23x33 cm (+/-1 cm marzh gabimi) me mbyllje me ngjitje, ngjyre e bardhë.
8	Bateri 1.5 V të vogla AAA	copë	Bateri 1.5 V të vogla AAA, Alkaline, për përdorim në pulte kondicioneri, pulte televizori, ora etj. cilësi, afat skadence minimumi 2 vjet.
9	Bateri 1.5 V të vogla AA	copë	Bateri 1.5 V të vogla AA, Alkaline, për përdorim në pulte kondicioneri, pulte televizori, ora, cilësi, afat skadence minimumi 2 vjet.
10	Bateri 6LR61 9V	copë	Bateri 6LR61 9V, në formë drejtkëndore ose cilindrike, alkaline, për përdorime të ndryshme, me afat skadence minimumi 2 vjet.

11	Bojë vulë blu	shishe	Bojë për vulë ngjyrë blu, e përshtatshme për të gjitha llojet e vulave. Bojë ekologjikisht e pastër dhe rezistente. Boja vjen në paketim 30ml. Kuti metalike/plastike.
12	CD-RË, 8-10X 700MB	copë	CD-RË, minimumi kapaciteti: 8-10X shpejtësi, 700 MB, përmasa standarde me kapak, e rishkrueshme. Sigurojnë ruajtje të sigurt dhe afatgjatë të skedarëve dhe dokumenteve të rëndësishëm, ideale për të gjitha fotot dhe videot.
13	32GB, USB 3.0	copë	USB me kapacitet 32GB, porta USB 3.0, sigurojnë ruajtje të sigurt dhe afatgjatë të të dhënave.
14	Evidenciator 4 ngjyra	pako	4 ngjyra te ndryshme, maja minimumi 4.5 mm, përmasat 12.4x1.75x1.2 cm, të mos fshihet.
15	Gërshëre zyre 20 cm, dorëzë plastike	copë	Gërshëre me dorëzë plastike, deri 20 cm.
16	Kapese aktesh Nr.33 mm	kuti	Per kapje letrash, nr.33, kutia me nga 100 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.
17	Kapese aktesh me veshë 25mm	kuti	Kapese me veshë 25 mm, kutia me nga 12 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.
18	Kapese aktesh me veshë 41mm	kuti	Kapese me veshë 41 mm, kutia me nga 12 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.
19	Korrektor stilo blister	copë	Korrektor 7 ml. Për përdorime të ndryshme, me tharje të shpejtë.
20	Kalkulator 12 digit	copë	Makinë llogaritëse 12 shifrore, me çelës fikje ndezje, me dy mënyra karikimi, përmasa minimumi 208x163x40mm.
21	Hapëse Vrimash, me 4 vrima 70 fletë	copë	Hapëse vrimash me 4 vrima, material plastik/metal, me vizore dhe kontenier për pritjen e mbetjeve deri në 70 fletë.
22	Heqëse teli pincë	copë	Të ketë formën standarde, madhësi normale, me sustë. Të jetë material inoxi, të ketë formën e pincës.

23	Marker për CD e zezë ose color	copë	Marker për CD e zezë ose ngjyra të ndryshme, me 2 anë 0.5-1mm .
24	Makinë qepje dokumentesh 24/6 në formë gërshërë	copë	Makinë qepje dokumentesh 24/6 në formë pice. Materiali metalik. Të kapë 30 fleta. Përmasa: minimumi 17.5 cm.
25	Marker permanent Kuti 4 ngjyrëshe	pako	Marker permanent kuti 4 ngjyrëshe, majë 1.2mm.
26	Mbajtëse dokumentesh 3 sirtarë me çelës	copë	Mbajtëse dokumentesh, me 3 sirtarë me çelës. Lartësia 20 cm, gjerësia 30 cm.
27	Lapsa me gome HB	copë	Laps grafiti me gomë për përdorim të përgjithshëm me fortësi HB. Të jetë material cilësor pako 12 copë. Pjesa e jashtme e lapsit të jetë me ngjyra të ndryshme sipas kërkesës së AK-së.
28	Prerëse lapsash plastike me depozitë	copë	Prerëse lapsi, forma katror & konike, me depozitë për mbetje.
29	Stilo 0.7 mm me ngjyra të ndryshme	copë	Stilo 0.7 mm me ngjyra të ndryshme sipas kërkesës së AK-së. Majë metalike gjilpërë 0.7 mm.
30	Stik i bardhë 40gr	copë	Ngjitës letre, i bardhë, në formë buzëkuqi, në 40 gr.
31	Shirit ngjitës transparent 15 mm x33m	copë	Shirit ngjitës , i tejdukshëm, përmasa 15mm x 33m .
32	Tela për makina kapëse aktesh 24/6	kuti	Tela për makina kapëse aktesh 24/6.
33	Vizore 30 cm	copë	Vizore plastike 30 cm, e shkallëzuar në milimetra dhe cm, material plastik i përkulshëm.
34	Zgjatues Elektrik me 5 pozicione, me çelës	copë	Zgjatues elektrik me pesë pozicione, me çelës, me gjatësi kabulli minimumi 1.5 m, kabulli të jetë i veshur me material PVC. Të ketë minimumin e amperazhit 10-16A, voltazhi 220-350 V. Ngjyrë e bardhë ose e zezë.
35	Letër fotokopje, 80gr/m ²	risma 500 fletë	-Përmasa 29.7x210, A4. -Lëmueshmëria: 80-130 ml/min. -Amballazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 risma. -Përdorimi për fotokopje dhe printim. -Lagështia: 3.5-4.5%. -Trashësia: 103-115 µm. -Dukshmëria: >94%. -Shkëlqimi: 101-115%. -CIE bardhësia: 148-170.

			<p>-Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin.</p> <p>-Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit.</p> <p>-Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit.</p> <p>-Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët.</p> <p>-Të plotësojë standardet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë sipas ISO-s 9706 ,80 gr/m²</p> <p>-Të mos jetë e ricikluar.</p> <p>-Me risma 500 flete secila.</p>
36	Tabak Kartoni	fletë	Tabak Kartoni i bardhe, 70x100cm.
37	Leter fotokopje, 80 gr/m ² , double A	risma 500 flete	Double A ose ekuivalente
38	Zarfa plastike(qese) me vrima, A4 , 100 copë/pako	pako	Material plastik, format A4, me vrima. Të dizenuar për të mbajtur brenda letra format A4. Një pako përmban 100 zarfe dhe tarshësia e zarfit duhet të jetë 100 micron.
39	Zarfa plastike(qese) me vrima, A4 , 100 copë/pako	pako	Material plastik, format A4, me vrima. Të dizenuar për të mbajtur brenda letra format A4. Një pako përmban 100 zarfe dhe tarshësia e zarfit duhet të jetë 40 micron.
40	Natërbani i madh	copë	Shirit ngjitës, transparent 48mmx50m
41	Zarfa 19x26 cm (A5) sigurie me numer serie	copë	Zarfi të ketë përmasat 19x26 cm (+/-1 cm marzh gabimi)me mbyllje me ngjitje, ngjyrë e bardhë.
42	Zarfa 23x33 cm (A4) sigurie me numer serie	copë	Të jenë letre, përmasat 23x33 cm (+/-1 cm marzh gabimi) me mbyllje me ngjitje, ngjyre e bardhë.
43	Gome per fshirjen e lapsit	copë	Me ngjyra te ndryshme dhe material i bute.
44	Highliter stilo	copë	Me ngjyra te ndryshme, me maje te ttrashe.
45	Leter A5 per printer Epson LQ-350	copë	Leter e vazhdueshme me vrima ne ane.
46	Etiketa adhesive labels me 8 ndarje	pako	Etiketa me 8 ndarje me permasa 105 x 74
47	Etiketa adhesive labels me 16 ndarje	pako	Etiketa me 16 ndarje me permasa 105 x 36
48	Kabëll rrjeti 5m	copë	Kabëll per lidhjen e PC me modemin
49	Kabëll rrjeti 10m	copë	Kabëll per lidhjen e PC me modemin
50	Kabëll per MSO	copë	Kabëll per lidhje me porta te tipeve te ndryshem.

51	Kabëll per printer	copë	Kabëll per lidhje me printerin
52	Lidhese llastiku (1kg)	pako	Lidhese llastiku
53	Blllok A5 per dergim poste	copë	Blllok me 3 ose 4 flete me ngjyre te ndryshme per secilin dergim poste.
54	Kompjuter Seal	copë	Vula plastike me numer serie per mbylljen nga mbrapa te kompjuterave.
55	Qese Per Shredder Ideal 3105,3804, 4000, 4002(100)	copë	Qese per mbledhje e mbeturinave te dala nga makinat grirese.
56	Qese për shredder Ideal 4605 (50)	copë	Qese per mbledhje e mbeturinave te dala nga makinat grirese.
57	Qese per shredder Kobra	copë	Qese per mbledhje e mbeturinave te dala nga makinat grirese
58	Vaj për Ideal Shredder Ilt	copë	Vaj per makinat grirese Shredder.
59	Bllloqe porosish	copë	Blllok me ngjitje, adeziv përmasa 76x76, min 100 fletë.

Shënim:

Në rast se në përbërje të zërave në specifikimet teknike do të gjenden emra marke do do të shtohet shprehja "ose ekuivalent i tij / e saj".

Afati i lëvrimit është 10 (dhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës/kontratave

Ndërkohë në shtojcën 6 “**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet lloji dhe sasia e shërbimeve objekt-prokurimi si më poshtë:

Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Axhendë ditore afërsisht 14.2x20.5 cm, min 300 faqe	copë	400

2	Dosje me mekanizëm, 7cm	copë	350
3	Dosje 4 unaza plastike, 3.5 cm	copë	55
4	Dosje kapak plastik me 2 kapëse	copë	500
5	Zarfa 11x23 cm	copë	10,000
6	Zarfa 19x26 cm (A5)	copë	10,000
7	Zarfa 23x33 cm (A4)	copë	1,500
8	Bateri 1.5 V të vogla AAA	copë	30
9	Bateri 1.5 V të vogla AA	copë	75
10	Bateri 6LR61 9V	copë	15
11	Bojë vulë blu	shishe	30
12	CD-RË, 8-10X 700MB	copë	70
13	32GB, USB 3.0	copë	30
14	Evidenciator 4 ngjyra	pako	150
15	Gërshëre zyre 20 cm, dorëzë plastike	copë	300

16	Kapese aktesh Nr.33 mm	kuti	50
17	Kapse aktesh me veshë 25mm	kuti	40
18	Kapse aktesh me veshë 41mm	kuti	40
19	Korrektor stilo blister	copë	50
20	Kalkulator 12 digit	copë	100
21	Hapëse Vrimash, me 4 vrima 70 fletë	copë	30
22	Heqëse teli pincë	copë	300
23	Marker për CD e zezë ose color	copë	300
24	Makinë qepje dokumentesh 24/6 në formë gërshërë	copë	210
25	Marker permanent Kuti 4 ngjyrëshe	pako	30
26	Mbajtëse dokumentesh 3 sirtarë me çelës	copë	100
27	Lapsa me gome HB	copë	30
28	Prerëse lapsash plastike me depozitë	copë	30
29	Stilo 0.7 mm me ngjyra të ndryshme	copë	1,500
30	Stik i bardhë 40gr	copë	40
31	Shirit ngjitës transparent 15 mm x33m	copë	40
32	Tela për makina kapëse aktesh 24/6	kuti	2,000

33	Vizore 30 cm	copë	40
34	Zgjatues Elektrik me 5 pozicione, me çelës	copë	15
35	Letër fotokopje, 80gr/m ²	risma 500 fletë	500
36	Tabak Kartoni	fletë	30
37	Leter fotokopje, 80 gr/m ² , double A	risma 500 flete	3
38	Zarfa plastike(qese) me vrima, A4 , 100 copë/pako	pako	70
39	Zarfa plastike(qese) me vrima, A4 , 100 copë/pako	pako	1,200
40	Natërbani i madh	copë	70
41	Zarfa 19x26 cm (A5) sigurie me numer serie	copë	70
42	Zarfa 23x33 cm (A4) sigurie me numer serie	copë	70
43	Gome per fshirjen e lapsit	copë	12
44	Highliter stilo	copë	200
45	Leter A5 per printer Epson LQ-350	copë	15
46	Etiketa adhesive labels me 8 ndarje	pako	15
47	Etiketa adhesive labels me 16 ndarje	pako	15
48	Kablla rrjeti 5m	copë	30
49	Kablla rrjeti 10m	copë	30
50	Kablla per MSO	copë	30
51	Kablla per printer	copë	30
52	Lidhese llastiku (1kg)	pako	3
53	Bllok A5 per dergim poste	copë	70
54	Kompjuter Seal	copë	1,200

55	Qese Per Shredder Ideal 3105,3804, 4000, 4002(100)	copë	65
56	Qese për shredder Ideal 4605 (50)	copë	60
57	Qese per shredder Kobra	copë	60
58	Vaj për shredder Ideal 1lt	copë	12
59	Blloqe porosish	copë	200

Afatet e lëvrimit: 10 (dhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës/kontratave.

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi”, të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
 - b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
 - c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
 - ç) të nxisë 13 konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
 - d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
 - dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.
- Ndërsa në nenin

3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në 17 mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.2.4. Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “ 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.2.5. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për

kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

III.2.6. Në nenin 8 dhe 9 të ligjit Nr.10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” citohet se: “Neni 8 Deklarata EC e konformitetit 1. Kur legjislacioni përkatës parashikon një deklaram nga prodhuesi se ai ka demonstruar përmbushjen e kërkesave për një produkt, prodhuesi harton një deklaratë të vetme EC të konformitetit për të gjitha aktet ligjore apo nënligjore të zbatueshme ndaj produktit, përfshirë dhe procedurën e vlerësimit të konformitetit, sipas moduleve përkatëse. 14 2. Deklarata EC e konformitetit hartohet/përkthehet në gjuhën shqipe dhe përmban elementet e mëposhtme: a) numrin e identifikimit unik të produktit; b) emrin dhe adresën e prodhuesit ose të përfaqësuesit të tij të autorizuar; c) objektin e deklaramit (identifikimin e produktit, që mundëson gjurmueshmërinë, kur është e përshtatshme mund të përfshijë edhe një fotografi), në përputhje me legjislacionin përkatës në lidhje me të; ç) referencën ndaj standardeve të harmonizuara përkatëse që janë zbatuar ose referencën ndaj specifikimeve teknike, në lidhje me të cilat është deklaruar përputhshmëria; d) kur është e aplikueshme, organizmin europian të notifikuar ose degën e tij të regjistruar në Shqipëri dhe të miratuar si organ i miratuar (emrin, numrin e identifikimit), duke treguar procedurën e vlerësimit të konformitetit dhe lëshimin e certifikatës; dh) datën, vendin dhe nënshkrimin. 3. Kjo deklaratë konformiteti lëshohet nën përgjegjësinë e vetme të prodhuesit ose, sipas rastit, instaluesit. 4. Me hartimin e deklaramës EC të konformitetit, prodhuesi ose, sipas rastit, instaluesi merr përsipër përgjegjësinë për përputhshmërinë e produktit me kërkesat ligjore në lidhje me to Neni 9 Markimi CE i konformitetit 1. Markimi CE i konformitetit vendoset vetëm nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar. 2. Markimi CE i konformitetit fiksohet në produkt përpara vendosjes së tij në treg. Ai mund të shoqërohet nga një piktogram ose ndonjë tregues për një përdorim ose rrezik të veçantë. 3. Markimi CE i konformitetit vendoset/fiksohet vetëm në produktet, për të cilat është parashikuar kjo vendosje/fiksim nga rregullat teknike të zbatueshme dhe nuk duhet të vendoset në produkte të tjera. 4. Markimi CE i konformitetit shoqërohet nga numri i identifikimit të organizmit europian të notifikuar, kur ky organ është përfshirë në fazën e kontrollit të prodhimit. Numri i identifikimit të organizmit europian të notifikuar vendoset/fiksohet nga vetë ai ose, sipas instruksioneve të tij, nga prodhuesi apo përfaqësuesi i tij i autorizuar. Me vendosjen ose fiksimin e markimit CE të konformitetit, prodhuesi merr përgjegjësinë për përputhshmërinë e produktit me të gjitha kërkesat e zbatueshme, të përcaktuara në legjislacionin përkatës/rregullat teknike që parashikojnë vendosjen e tij. 5. Forma, kuptimi dhe simboli grafik i markimit të konformitetit përcaktohen në rregullat teknike përkatëse, referuar në nenin 5 të këtij ligji. 6. Ndalohet vendosja e markimit/markimeve, shenjave apo mbishkrimeve, të cilat mund të çorientojnë palët e treta për kuptimin, formën e markimit CE të konformitetit, të përcaktuar në rregullat teknike përkatëse. Çdo markim tjetër mund të vendoset në produkt, në mënyrë të tillë që të mos pengojë dukshmërinë, lexueshmërinë dhe kuptimin e markimit CE të konformitetit. 7. Markimi CE i

konformitetit vendoset/fiksohet në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme në produkt ose në pllakën e tij të të dhënave. Kur kjo nuk është e mundur për shkak të natyrës së produktit, markimi vendoset në paketim ose në dokumentet shoqëruese, në qoftë se rregulli teknik përkatës parashikon dokumente të tilla. 8. Kur produkti mbulohet nga disa rregulla teknike, vendosja e markimit CE të konformitetit në produkt tregon se produkti i plotëson të gjitha kërkesat e përcaktuara në rregullat teknike përkatëse për këtë produkt.”.

III.2.7. Referuar rastit konkret, KPP gjykon, se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor lidhur me kërkesën, që Operatori ekonomik duhet të deklarojë në tabelën e përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit nga autoriteti kontraktor, se artikujt e ofertuar duhet të kenë Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent akredituar, një përcaktim i tillë është i përshtatshëm për arritjen e synimit të autoritetit kontraktor, për verifikimin e cilësisë së produkteve, por kjo kërkesë e përcaktuar nga ana e AK në lidhje disponimin e Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent akredituar për artikujt e parashikuar në grafikun e lëvrimit nuk varet nga vullneti i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, pasi një kërkesë e tillë për produktet përcaktohet nga vetë prodhuesit e produkteve. Ndaj në këtë rast, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm në lidhje me certifikimin, pra të aplikohet në ato raste kur certifikimi është i aplikueshëm, pasi jo për çdo artikull certifikimi është i aplikueshëm, ndaj Komisioni gjykon se, Autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin duke vendosur togfjalëshin në lidhje me certifikatat për artikujt “kur është e aplikueshme”, në përputhje dhe me ligjin Nr.10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”.

III.2.8. Ndërsa lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor, ku operatorët ekonomikë në përmbushje të tabelës duhet të deklarojnë dhe vendin e origjinës, duke e vendosur si kriter kualifikues, KPP vëren, se autoriteti në argumentimin e këtij kriteri ka cituar se: “**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standartit CE/ ose ekuivalent dhe direktivave lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi”. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në kërkesën e tij për deklarimin e vendit të origjinës, në asnjë moment nuk ka argumentuar teknikisht kërkesën e tij. Kjo kërkesë nuk i shërben objektit të kësaj procedure prokurimi, si edhe nuk i shërben qëllimit të kontratës dhe nuk ka një rol thelbësor në realizimin e kësaj procedure prokurimi. Autoriteti Kontraktor duhet ta modifikojë këtë kërkesë, duke e hequr atë.

III.2.9 Autoriteti në kërkesën e mësipërme ka përcaktuar: “Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK certifikatat e cdo produkti jo me vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar.”

”Me nenshkrimin e kontrates dhe dorezimin e artikujve operatori ekonomik krahas mallrave objekt prokurimi të paraqes pranë AK për cdo produkt certifikatat e origjinës. Për këto të

paraqes detyrimisht nje deklarate se cdo produkt do te shoqerohet me certifikatat perkatëse të origjinës.” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin e kriterëve specifike, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, përcaktojnë se kriteret e kualifikimit duhet të jenë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Në interpretimin teleologjik (qëllimit) të dispozitës së sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se qëllimi i vendosur nga ligjvënësi, është dhënia e mundësisë së autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike (referuar nenit 21 pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) nga autoriteti kontraktor, të mostrave të dorëzuara, në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruara në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Ligjvënësi ka kufizuar të drejtën e autoritetit kontraktor mbi vendosjen e kriterit të mësipërm të kualifikimit në respekt të parimit të proporcionalitetit, si një parim gjithëpërfshirës në ligjin e prokurimit publik, duke e lidhur vendosjen e kriterit me rëndësinë që ka për vlerësimin e ofertës teknike. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin, nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 të LPP-së. Komisioni konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton, se për përmbushjen e synimit autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, si edhe kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësisë të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave për disa nga artikujt objekt-prokurimi. Referuar nenit 40, pika 6 gërma “a” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkesa për paraqitjen e mostrave, parashikohet si një ndër kërkesat e cila duhet përmbushur për kualifikimin e operatorëve ekonomikë. Pra ligjvënësi ka parashikuar këtë kërkesë, si një kriter i cili duhet përmbushur nga operatori ekonomik i cili synon të fitojë kontratën, dhe ky kriter i shërben autoritetit, pra në fazën e vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurë. Sa më sipër, kërkesa mbi momentin e dorëzimit të mostrave “jo më vonë se pesë ditë nga shpallja e njoftimit përfundimtar të fituesit”, është një kërkesë e cila nuk i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor, sipas përcaktimeve të nenit 40 të VKM-së. Sa më sipër autoriteti kontraktor, të modifikojë kërkesën e mësipërme në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

III.2.10 Lidhur me kërkesën e AK ”Me nenshkrimin e kontrates dhe dorezimin e artikujve, operatori ekonomik krahas mallrave objekt prokurimi te paraqese prane AK per cdo produkt certifikatat e origjinës. Per kete te paraqese detyrimisht nje deklarate se cdo produkt do te shoqerohet me certifikatat perkatëse të origjinës. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet

dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i termave të referencës/specifikimet teknike, Komisioni gjykon, se bazuar në objektin e procedurës së prokurimit, volumit dhe elementeve konkrete të kontratës objekt-prokurimi, kërkesat e mësipërme për disponimin e certifikatave të konformitetit ose të cilësisë CE/Ekuivalent, si dhe certifikatën e origjinës, ku krahas kësaj detyrimisht dhe deklaratën se çdo produkt do të shoqërohet me certifikatat përkatëse sipas specifikimeve të AK, janë të ekzagjeruara dhe përtej asaj çfarë është e nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj kontrate, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të sigurohet që operatorët ekonomikë ofertues të disponojnë produktin, por duke u siguruar me cilësinë e saj me anë të një kërkesë për të zbatuar me sukses kontratën objekt-prokurimi. Kërkesa për disponimin e deklaratës, certifikatave të konformitetit ose cilësisë CE/ekuivalent, dhe për çdo produkt certifikatën e origjinës, nuk është e domosdoshme për zbatim me sukses të një kontrate, pasi nuk është aq komplekse. Gjithashtu, në bazë të shqyrtimit në DST të procesverbalit për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, KPP vëren, se në lidhje me kriterin e vendosur, autoriteti kontraktor nuk e ka argumentuar teknikisht vendosjen e saj. Akoma më tej, kriteret e veçanta të kualifikimit, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Për sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin duke e hequr atë.

Për sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, se: “[...]“Afatet e lëvrimin: Afati i lëvrimin të mallit është 10 (dhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës/kontratave. Në lidhje me sa është kërkuar nga ana e juaj, pretendojmë se ky afat është tepër i shkurtër, kjo pasi bëhet fjalë për furnizimin me sasi të konsiderueshme të artikujve të cilët importohen nga furnitore të ndryshme ndërkombetare. Duke qene se operatorët ekonomikë për artikujt objekt i kësaj procedure prokurimi duhet të marrin furnizimin nga furnitorë të huaj dhe duke marrë në konsideratë kushtet aktuale të globale të shkaktuara nga Pandemia Covid-19 si dhe lufta në Ukrainë, kaosi i shkaktuar lidhur me transportin dhe rritja shumë e madhe e çmimeve të tij, e bëjnë shumë të vështirë që malli të merret nga jashtë shtetit dhe të lëvrohet në adresën tuaj brenda afatit të përcaktuar në dst. Të ndodhur në kushtet e krizës botërore për sa i përket transportit dhe lëvrimin të mallrave, kërkojmë që afati i lëvrimin të jetë minimalisht 30 ditë

nga data e lidhjes së kontratës. Theksojmë se kërkesa e AK është në shkelje të ligjit LPP dhe Nenit 40 të rregullores së prokurimit Publik. Për të gjitha sa u parashtruan më sipër, në zbatim dhe përputhje me Ligjin nr. 162/2020 për Prokurimin Publik; Vendimin nr. 285 datë 19.05.2021 të këshillit të Ministrave për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, kërkojmë që Autoriteti Kontraktor Gjykata e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm, Tiranë dhe Komisioni i Prokurimit Publik, të ndryshojë kriterin e mesiperm si të pabazuar në ligj dhe në prova. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën **Shtojca 6**. “FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Afatet e lëvrimit: 10 (dhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës/kontratave.

III.3.2. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.3.3. Neni 3 Parime të përgjithshme *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.3.4. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor *1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi*

III.3.5 Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e

nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në rastin konkret nga ana e ankimuesit kërkohet rritja e afatit të lëvrimin, pasi përcaktimi në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankim *Afatet e lëvrimin: 10 (dhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës/kontratave*, është jo i mjaftueshëm për lëvrimin e mallit në kohë dhe cilësi sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

III.3.6. Sa më sipër, KPP referuar pretendimit të ankimuesit, si dhe mallit për sasinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor gjykon, se periudha e përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi nuk është e mjaftueshme për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të prokurimit, duke pasur parasysh sasinë e konsiderueshme të mallit që do të lëvrohet, volumit të kontratës dhe shpërndarjes së tyre. Ndaj KPP gjykon, se afati i lëvrimin të mallit në rastin konkret duhet të rritet në përputhje me volumin dhe përmasat e kontratës, në mënyrë që ofertuesve t'ju lihet koha e nevojshme për të siguruar në kohë mallin me karakteristikat dhe specifikimet e kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Për rrjedhojë autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e afatit të lëvrimin të mallit në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit “Marketing& Distribution” SHPK qëndron.

III.4 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distributio” SHPK Dhe Infosoft Office” SHPK:
“Marketing&Distribution” SHPK

Këto specifikime në lidhje me artikujt e lartpërmendur nuk e justifikojnë qëllimin për të cilin janë vendosur, pasi specifikime teknike të tilla nuk garantojnë cilësinë ose standardin e lartë për këtë produkt. Ndër të tjera konstatojmë se specifikimet teknike të artikujve të sipërpërmendur, të përcaktuara nga ana AK janë kufizuese, diskriminuese dhe nuk garantojnë të drejtën e operatorëve ekonomike të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi. Theksojmë se për të shmangur një situatë të tillë e cila të bën të mendosh se AK mund të adresojë në një markë të caktuar apo po kufizon konkurrencën, duhet të parashikoni specifikime për artikujt e mësipërm me një rang më të madh të parametrave duke përcaktuar një marzh me të gjerë

specifikimesh e cila krijon mundësinë e ofertimit të artikujve të ndryshëm, por gjithmonë cilësore nga operatorë ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Infosoft Office” SHPK:

Per artikullin Nr. 14 AK ka kerkuar: 14 Evidenciator 4 ngjyra 4 ngjyra te ndryshme, maja minimumi 4.5 mm, përmasat 12.4x1.75x1.2 cm, të mos fshihet. Pako 150 Vendosja e permasave te trupit, aq me teper ne parametra kaq fikse, nuk ndikon fare ne funksionalitet te produktit. Kerkojme te hiqen permasat e trupit per kete artikull

**Per artikullin Nr. 22 AK ka kerkuar: 22 heqëse teli pincë TË ketë formën standarde, madhësi normale, me sustë. TË jetë material inoxi, të ketë formën e pincës. Copë 300 Materiali i artikullit te mesiperm nuk ndikon aspak ne funksionalitetin e tij, perkundrazi nga eksperiencia jone perdoren me shume heqeset e telit me doreze plastike, duke qene se jane me te pershtatshme per doren.*

**Per artikullin Nr. 24 AK ka kerkuar: 24 makinë qepje dokumentesh 24/6 në formë gërshërë makinë qepje dokumentesh 24/6 në formë pice. Materiali metalik. TË kapë 30 fleta. Përmasa: minimumi 17.5 cm. Copë 210 Parametri qe percakton numrin e fleteve, eshte permasa e telit (ne rastin konkret 24/6) kerkesa per numrin e fleteve (30 flete), materialin metalik dhe gjatesia e makines minimumi 17.5 cm, krijojne konfuzion, kufizojne konkurrencen dhe nuk ndikojne ne funksionalitetin e ketij artikulli.*

**Per artikullin Nr. 25 AK ka kerkuar: 25 Marker permanent Kuti 4 ngjyrëshe Marker permanent kuti 4 ngjyrëshe, majë 1.2mm.pako 30 Maja fikse 1.2 mm kufizon konkurrencen deh ka nje diapazon fiks. AK duhet te pranoj dhe nje marker me nje maje me te trashe.*

**? Per artikullin Nr. 27 AK ka kerkuar: 27 Lapsa me gome HB Laps grafiti me gomë për përdorim të përgjithshëm me fortësi HB. TË jetë material cilësor pako 12 copë. Pjesa e jashtme e lapsit të jetë me ngjyra të ndryshme sipas kërkesës së AK-së. Copë 30 Vendosja e kriterit per pamjen e jashtme te lapsit eshte e ekzagjeruar dhe nuk ndikon aspak ne funksionalitetin e tij*
Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 5 autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator

specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Njësia</i>	<i>Specifikime teknike</i>
<i>1</i>	<i>Axhendë ditore afërsisht 14.2x20.5 cm, min 300 faqe</i>	<i>copë</i>	<i>Axhenda ditore të ketë përmasat 14.2x20.5 cm (\pm 2 cm marzh gabimi), minimumi të ketë 300 faqe, të shkruhet viti, me logo ose jo sipas kërkesës së AK, me ngjyra të ndryshme sipas kërkesës së AK.</i>
<i>2</i>	<i>Dosje me mekanizëm, 7cm</i>	<i>copë</i>	<i>Dosje me mekanizëm A4 me kuti, 28x35x7 cm (marzh gabimi +/- 2 cm), me kuti, ngjyra të ndryshme sipas kërkesës së AK-së, me unazë metalike. Ngjyra e kutisë të jetë e njëjtë me ngjyrën e dosjes.</i>
<i>3</i>	<i>Dosje 4 unaza plastike, 3.5 cm</i>	<i>copë</i>	<i>Dosje A4 me 4 unaza. Kapaku të ketë trashësinë 500-700 mic. Përmasa 25x31x3.5 cm (marzh gabimi +/- 2 cm). Me ngjyra të ndryshme sipas kërkesave të AK-së.</i>
<i>4</i>	<i>Dosje kapak plastik me 2 kapëse</i>	<i>copë</i>	<i>Dosja të jetë material plastik, të ketë nga brenda 2 kapëse për fiksimin e materialeve, kapaku i parë të jetë transparent kapaku i dytë të jetë me ngjyra të ndryshme sipas kërkesës së AK-së. Përmasat e dosjes format A4.</i>
<i>5</i>	<i>Zarfa 11x23 cm</i>	<i>copë</i>	<i>Zarfi të ketë përmasat 11x23 cm (+/-1 cm marzh gabimi) me mbyllje me ngjitje, ngjyre e bardhë.</i>
<i>6</i>	<i>Zarfa 19x26 cm (A5)</i>	<i>copë</i>	<i>Zarfi të ketë përmasat 19x26 cm (+/-1 cm marzh gabimi) me mbyllje me ngjitje, ngjyrë e bardhë.</i>
<i>7</i>	<i>Zarfa 23x33 cm (A4)</i>	<i>copë</i>	<i>Të jenë letre, përmasat 23x33 cm (+/-1 cm marzh gabimi) me mbyllje me ngjitje, ngjyre e bardhë.</i>
<i>8</i>	<i>Bateri 1.5 V të vogla AAA</i>	<i>copë</i>	<i>Bateri 1.5 V të vogla AAA, Alkaline, për përdorim në pulte kondicioneri, pulte televizori, ora etj. cilësi, afat skadence minimumi 2 vjet.</i>
<i>9</i>	<i>Bateri 1.5 V të vogla AA</i>	<i>copë</i>	<i>Bateri 1.5 V të vogla AA, Alkaline, për përdorim në pulte kondicioneri, pulte televizori, ora, cilësi, afat skadence minimumi 2 vjet.</i>
<i>10</i>	<i>Bateri 6LR61 9V</i>	<i>copë</i>	<i>Bateri 6LR61 9V, në formë drejtkëndore ose cilindrike, alkaline, për përdorime të ndryshme, me afat skadence minimumi 2 vjet.</i>

11	Bojë vulë blu	shishe	Bojë për vulë ngjyrë blu, e përshtatshme për të gjitha llojet e vulave. Bojë ekologjikisht e pastër dhe rezistente. Boja vjen në paketim 30ml. Kuti metalike/plastike.
12	CD-RË, 8-10X 700MB	copë	CD-RË, minimumi kapaciteti: 8-10X shpejtësi, 700 MB, përmasa standarde me kapak, e rishkrueshme. Sigurojnë ruajtje të sigurt dhe afatgjatë të skedarëve dhe dokumenteve të rëndësishëm, ideale për të gjitha fotot dhe videot.
13	32GB, USB 3.0	copë	USB me kapacitet 32GB, porta USB 3.0, sigurojnë ruajtje të sigurt dhe afatgjatë të të dhënave.
14	Evidenciator 4 ngjyra	pako	4 ngjyra te ndryshme, maja minimumi 4.5 mm, përmasat 12.4x1.75x1.2 cm, të mos fshihet.
15	Gërshërë zyre 20 cm, dorëzë plastike	copë	Gërshërë me dorëzë plastike, deri 20 cm.
16	Kapese aktesh Nr.33 mm	kuti	Per kapje letrash, nr.33, kutia me nga 100 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.
17	Kapese aktesh me veshë 25mm	kuti	Kapese me veshë 25 mm, kutia me nga 12 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.
18	Kapese aktesh me veshë 41mm	kuti	Kapese me veshë 41 mm, kutia me nga 12 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.
19	Korrektor stilo blister	copë	Korrektor 7 ml. Për përdorime të ndryshme, me tharje të shpejtë.
20	Kalkulator 12 digit	copë	Makinë llogaritëse 12 shifrore, me çelës fikje ndezje, me dy mënyra karikimi, përmasa minimumi 208x163x40mm.
21	Hapëse Vrimash, me 4 vrima 70 fletë	copë	Hapëse vrimash me 4 vrima, material plastik/metal, me vizore dhe kontenier për pritjen e mbetjeve deri në 70 fletë.
22	Heqëse teli pincë	copë	Të ketë formën standarde, madhësi normale, me sustë. Të jetë material inoxi, të ketë formën e pincës.

23	Marker për CD e zezë ose color	copë	Marker për CD e zezë ose ngjyra të ndryshme, me 2 anë 0.5-1mm .
24	Makinë qepje dokumentesh 24/6 në formë gërshërë	copë	Makinë qepje dokumentesh 24/6 në formë pice. Materiali metalik. Të kapë 30 fleta. Përmasa: minimumi 17.5 cm.
25	Marker permanent Kuti 4 ngjyrëshe	pako	Marker permanent kuti 4 ngjyrëshe, majë 1.2mm.
26	Mbajtëse dokumentesh 3 sirtarë me çelës	copë	Mbajtëse dokumentesh, me 3 sirtarë me çelës. Lartësia 20 cm, gjerësia 30 cm.
27	Lapsa me gome HB	copë	Laps grafiti me gomë për përdorim të përgjithshëm me fortësi HB. Të jetë material cilësor pako 12 copë. Pjesa e jashtme e lapsit të jetë me ngjyra të ndryshme sipas kërkesës së AK-së.
28	Prerëse lapsash plastike me depozitë	copë	Prerëse lapsi, forma katror & konike, me depozitë për mbetje.
29	Stilo 0.7 mm me ngjyra të ndryshme	copë	Stilo 0.7 mm me ngjyra të ndryshme sipas kërkesës së AK-së. Majë metalike gjilpërë 0.7 mm.
30	Stik i bardhë 40gr	copë	Ngjitës letre, i bardhë, në formë buzëkuqi, në 40 gr.
31	Shirit ngjitës transparent 15 mm x33m	copë	Shirit ngjitës , i tejdukshëm, përmasa 15mm x 33m .
32	Tela për makina kapëse aktesh 24/6	kuti	Tela për makina kapëse aktesh 24/6.
33	Vizore 30 cm	copë	Vizore plastike 30 cm, e shkallëzuar në milimetra dhe cm, material plastik i përkulshëm.
34	Zgjatues Elektrik me 5 pozicione, me çelës	copë	Zgjatues elektrik me pesë pozicione, me çelës, me gjatësi kabulli minimumi 1.5 m, kabulli të jetë i veshur me material PVC. Të ketë minimumin e amperazhit 10-16A, voltazhi 220-350 V. Ngjyrë e bardhë ose e zezë.
35	Letër fotokopje, 80gr/m ²	risma 500 fletë	-Përmasa 29.7x210, A4.
			-Lëmueshmëria: 80-130 ml/min.
			-Amballazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 risma.
			-Përdorimi për fotokopje dhe printim.
			-Lagështia: 3.5-4.5%.
			-Trashësia: 103-115 µm.
			-Dukshmëria: >94%.
			-Shkëlqimi: 101-115%.
-CIE bardhësia: 148-170.			

			<p>-Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin.</p> <p>-Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit.</p> <p>-Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit.</p> <p>-Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët.</p> <p>-Të plotësojë standardet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë sipas ISO-s 9706 ,80 gr/m²</p> <p>-Të mos jetë e ricikluar.</p> <p>-Me risma 500 flete secila.</p>
36	Tabak Kartoni	fletë	Tabak Kartoni i bardhe, 70x100cm.
37	Leter fotokopje, 80 gr/m ² , double A	risma 500 flete	Double A ose ekuivalente
38	Zarfa plastike(qese) me vrima, A4 , 100 copë/pako	pako	Material plastik, format A4, me vrima. Të dizenuar për të mbajtur brenda letra format A4. Një pako përmban 100 zarfe dhe tarshësia e zarfit duhet të jetë 100 micron.
39	Zarfa plastike(qese) me vrima, A4 , 100 copë/pako	pako	Material plastik, format A4, me vrima. Të dizenuar për të mbajtur brenda letra format A4. Një pako përmban 100 zarfe dhe tarshësia e zarfit duhet të jetë 40 micron.
40	Natërbani i madh	copë	Shirit ngjitës, transparent 48mmx50m
41	Zarfa 19x26 cm (A5) sigurie me numer serie	copë	Zarfi të ketë përmasat 19x26 cm (+/-1 cm marzh gabimi)me mbyllje me ngjitje, ngjyrë e bardhë.
42	Zarfa 23x33 cm (A4) sigurie me numer serie	copë	Të jenë letre, përmasat 23x33 cm (+/-1 cm marzh gabimi) me mbyllje me ngjitje, ngjyre e bardhë.
43	Gome per fshirjen e lapsit	copë	Me ngjyra te ndryshme dhe material i bute.
44	Highliter stilo	copë	Me ngjyra te ndryshme, me maje te ttrashe.
45	Leter A5 per printer Epson LQ-350	copë	Leter e vazhdueshme me vrima ne ane.
46	Etiketa adhesive labels me 8 ndarje	pako	Etiketa me 8 ndarje me permasa 105 x 74
47	Etiketa adhesive labels me 16 ndarje	pako	Etiketa me 16 ndarje me permasa 105 x 36
48	Kabëll rrjeti 5m	copë	Kabëll per lidhjen e PC me modemin
49	Kabëll rrjeti 10m	copë	Kabëll per lidhjen e PC me modemin
50	Kabëll per MSO	copë	Kabëll per lidhje me porta te tipeve te ndryshem.

51	<i>Kabëll per printer</i>	<i>copë</i>	<i>Kabëll per lidhje me printerin</i>
52	<i>Lidhese llastiku (1kg)</i>	<i>pako</i>	<i>Lidhese llastiku</i>
53	<i>Bllok A5 per dergim poste</i>	<i>copë</i>	<i>Bllok me 3 ose 4 flete me ngjyre te ndryshme per secilin dergim poste.</i>
54	<i>Kompjuter Seal</i>	<i>copë</i>	<i>Vula plastike me numer serie per mbylljen nga mbrapa te kompjuterave.</i>
55	<i>Qese Per Shredder Ideal 3105,3804, 4000, 4002(100)</i>	<i>copë</i>	<i>Qese per mbledhje e mbeturinave te dala nga makinat grirese.</i>
56	<i>Qese për shredder Ideal 4605 (50)</i>	<i>copë</i>	<i>Qese per mbledhje e mbeturinave te dala nga makinat grirese.</i>
57	<i>Qese per shredder Kobra</i>	<i>copë</i>	<i>Qese per mbledhje e mbeturinave te dala nga makinat grirese</i>
58	<i>Vaj për Ideal Shredder Ilt</i>	<i>copë</i>	<i>Vaj per makinat grirese Shredder.</i>
59	<i>Bllaqe porosish</i>	<i>copë</i>	<i>Bllok me ngjitje, adeziv përmasa 76x76, min 100 fletë.</i>

Shënim:

Në rast se në përbërje të zërave në specifikimet teknike do të gjenden emra marke do do të shtohet shprehja "ose ekuivalent i tij / e saj".

Afati i lëvrimit është 10 (dhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës/kontratave

III.4.2 Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifitimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifitimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifitimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifitime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.4.3. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifitimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifitimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifitimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të

lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështetet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”*

Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet “*Specifikime teknike*” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testim, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”

Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: “*specifikim teknik*” nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni Europian vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “*Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.*”

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë, që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të parashtrajnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se ligji 162/2020 “Për

prokurimin publik” është përafruar pjesërisht edhe me *Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar*. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): "Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar". Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (*qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit*), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP thekson, se fakti se një ose disa produkte të një ose disa prodhuesve vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor, nuk përbën një kusht *sine qua non*, se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik *onus probandi incubit actor* (barra e provës i bie kërkuesit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “*në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”. Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë, se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin, se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtarë/ndërkombëtarë me reputacion. Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, nënvizon se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit duhet ti përmbahet *stricto-sensu* vetëm metodave të parashikuara në nenin 36 të ligjit për prokurimin publik.

III.4.4. Nga shqyrtimi i specifikimeve teknike Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se autoriteti kontraktor, gjatë hartimit të specifikimeve teknike, ka përshkruar në mënyrë tepër të detajuar produktet që kërkon të blejë me anë të kësaj procedure prokurimi. Komisioni vëren se, në shumicën e rasteve, specifikimet teknike janë hartuar me përcaktime fikse, duke kufizuar ndjeshëm konkurrencën, si dhe duke privuar nga e drejta e ofertimit operatorë ekonomikë të interesuar, të cilët mund të ofrojnë produkte me kapacitete edhe më të mira. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publike është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit, duke përfshirë edhe hartimin e specifikimeve teknike.

Përcaktimi në mënyrë të detajuar i specifikave që nuk ndikojnë në funksionalitetin apo nuk vërtetojnë cilësinë e artikujve objekt-prokurimi, si dhe përcaktimi i parametrave fikse, duke i kufizuar në mënyrë eksplicite ato, kufizon pjesëmarrjen në këtë procedurë prokurimi e për pasojë kufizon konkurrencën. Gjithashtu, konstatohet, se janë përcaktuar specifikime teknike që nuk ndikojnë aspak në funksionalitetin e artikujve.

III.4.5. Më konkretisht, në rastet e artikujve të tjerë të sipërpërmendur, autoriteti kontraktor ka përcaktuar parametra fikse dhe specifikimet teknike që nuk ndikojnë aspak në funksionalitetin apo performancën e pajisjeve të mësipërme, duke kufizuar ndjeshëm konkurrencën. Referuar specifikimeve teknike, Komisioni gjykon, se për artikujt që do të prokurohen, specifikimet teknike mund të hartohen më lehtësisht për ofertimin nga ana e operatorëve ekonomikë. Për këtë arsye, specifikimet teknike lidhur me këto të fundit, duhet të modifikohen duke caktuar një parametër minimal/maksimal ose diapazon të pranueshëm me qëllim hapjen e konkurrencës. Përcaktime fikse të tilla, kufizojnë në mënyrë të panevojshme konkurrencën, pasi përjashton ata operatorë ekonomikë që ofertojnë artikujt e mësipërm me parametrat dhe cilësitë funksionale të kërkuara. Për këtë arsye, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimet teknike duke hequr të gjitha ato specifikime teknike që nuk lidhen drejtpërdrejtë me funksionalitetin e pajisjeve të mësipërme, si dhe të vendosë diapazon të arsyeshëm për parametrat funksionalë të tyre, me qëllim hapjen e konkurrencës.

Gjithashtu, lidhur me kërkesat e operatorit ekonomik “Infosoft Office” në lidhje me artikujt me nr rendor (14; 22; 27;) autoriteti duhet të modifikojë specifikimet teknike për të cilat operatori ekonomik ankimon.

Sa me sipër, pretendimet e operatoreve ekonomik ankimues qendrojnë.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distributio” SHPK Dhe Infosoft Office” SHPK:

“Infosoft Office” SHPK

-Per artikullin Nr. 1 AK ka kerkuar: 1 axhendë ditore afërsisht 14.2x20.5 cm, min 300 faqe Axhenda ditore të ketë përmasat 14.2x20.5 cm (2 cm marzh gabimi), minimumi të ketë 300 faqe, të shkruhet viti, me logo ose jo sipas kërkesës së AK, me ngjyra të ndryshme sipas kërkesës së AK. Copë 400 Te saktësohet nga ana e AK, nese artikulli i mesiperm nevojitet te jete me logo ose jo pasi ka ndryshime ne koston e produktit dhe kjo ndikon ne ofertimin qe do te behet nga ana jone ne lidhje me kete artikull.

- Per artikullin Nr. 27 AK ka kerkuar: 27 Lapsa me gome HB Laps grafiti me gomë për përdorim të përgjithshëm me fortësi HB. Të jetë material cilësor pako 12 copë. Pjesa e jashtme e lapsit të jetë me ngjyra të ndryshme sipas kërkesës së AK-së. Copë 30 Vendosja e kriterit per pamjen e jashtme te lapsit eshte e ekzagjeruar dhe nuk ndikon aspak ne funksionalitetin e tij. Gjithashtu

per kete artikull eshte e paqarte sasia qe nevojitet, nese duhet te jete 30 cope apo 30 pako? Ju lutem saktsoni sasine qe deshironi per kete artikull.

- Per artikullin Nr. 37 AK ka kerkuar: 37 Leter fotokopje, 80 gr/m, double A Double A ose ekuivalente risma 500 flete 3 Ju lutem specifikoni permasat e sakta te letres qe kerkoet.

- Per artikullin Nr. 41 dhe 42 AK ka kerkuar: 41 Zarfa 19x26 cm (A5) sigurie me numer serie Zarfi të ketë përmasat 19x26 cm (+/-1 cm marzh gabimi) me mbyllje me ngjijte, ngjyrë e bardhë. Copë 70 42 Zarfa 23x33 cm (A4) sigurie me numer serie te jenë letre, përmasat 23x33 cm (+/-1 cm marzh gabimi) me mbyllje me ngjijte, ngjyre e bardhë. Copë 70 Ju lutem per keto dy artikuj, nga ana e AK te jepen me shume specifikime teknike dhe te mundesojne nje foto ilustruese te produktit qe kerkojne.

- Per artikullin Nr. 45 AK ka kerkuar: 45 Leter A5 per printer Epson LQ-350 Leter e vazhdueshme me vrime ne ane. Copë 15 Ju bejme me dije se letra e vazhdueshme eshte me nje, dy ose tre kopje. Ju lutem saktsoni sa kopje deshironi.

- Per artikullin Nr. 45 AK ka kerkuar: 50 Kabuj per msokabëll per lidhje me porta te tipeve te ndryshem. Copë 30 Nuk e kemi te qarte ate cfare kerkoet nga AK. Ju luem na mundsoni me shume specifikime teknike dhe foto ilustruese te produktit qe ju kerkon.

- Per artikullin Nr. 54 AK ka kerkuar: 54 Kompjuter Seal Vula plastike me numer serie per mbylljen nga mbrapa te kompjuterëve. Copë 1,200 Nuk e kemi hasur ndonjehere kete kerkese pasi ky artikull nuk eshte produkt kancelarie. Ju lutem, na jepni me shume specifikime dhe nje foto ilustruese te produktit.

-Per artikullin Nr. 57 AK ka kerkuar: 57 Qese per shredder Kobra Qese per mbledhje e mbeturinave te dala nga makinat grirese copë 60 Ju lutem saktsoni se cfare modeli Kobra, pasi modele te ndryshme perdorin qese te ndryshme.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ‘Marketing& Distribution’ SHPK

-Sa më sipër, përcaktimi nga autoriteti kontraktor i specifikimeve për artikullin nr. 41 zarfe 19x26 cm (A5) sigurie me numer serie, artikullin nr. 42 zarfe 23x33 cm (A4) sigurie me numer serie na detyron që të kërkojmë nga autoriteti kontraktor që për këtë artikull të specifikoni elementin e sigurisë që kërkoet dhe të na mundësoni foto të produktit për të ofertuar pasi nuk është zarf standard.

-Në lidhje me artikullin nr. 54 kompjuter Sealw kërkojmë nga ana e grupit të shqyrtimit të ankesës që të specifikoni artikullin që kërkoet dhe të na mundësoni foto të produktit për të ofertuar pasi nuk është artikull standard.

II.5.1 Lidhur me pretendimet e mesiperme të operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK dhe në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik “Marketing& Distribution” SHPK , Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi para kërkimit për sqarime mbi specifikimet teknike të artikujve të procedurës së prokurimit. Në rastin konkret, Komisioni gjykon, se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikim ligjor apo specifikim teknik në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik), por në thelb janë paqartësi mbi specifikimet teknike të artikujve të sipërcituara. Gjithashtu, KPP-ja konstaton, se autoriteti

kontraktor, nuk ka dhënë një përgjigje në lidhje me ankesën e operatorëve ekonomikë ankimues, në kundërshtim me nenin 75 të LPP-së i cili parashikon shprehimisht se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.*

Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.”. Pra AK nuk ka dhënë sqarime për operatorët ekonomikë ankimues, lidhur me kërkesat e tyre për sqarim. Ndaj Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të sqarojë operatorin ekonomik ankimues në mënyrë të argumentuar dhe shteruese lidhur me paqartësitë e parashtruara në ankesë. Gjithashtu, Komisioni sjell në vëmendje, se këto sqarime duhet të publikohen në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së.

Sa më sipër, pretendimet e operatoreve ekonomikë ankimues qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-75647-07-20-2023 me objekt “Blerje kancelari”, me fond limit 4,981,157.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 31-07-2023, nga autoriteti kontraktor Identitek Sh.A.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Marketing& Distribution” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, dhe të publikojë sqarimet në bazë të nenit 75 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Marketing& Distribution” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

